



QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE

Studim: “Përshtatshmëria e kultivarëve të rinj të Shegës”.

1. Hyrje

Shega është një nga kulturat që në vitet e fundit po merr një përhapje shumë të madhe në të gjitha vendet për shkak të vëmendjes që po i kushtohet për vlerat që kjo bimë ka në shëndetin e njeriut. Edhe në vendin tonë është duke u ndjekur ky trend që në fakt kushtëzohet edhe nga kërkesa e tregut. Shega tek ne gjendet e kultivuar pothuajse në të gjithë vendin, madje në formë të egër gjendet e përhapur në Veriun e Shqipërisë dhe në vende të tjera edhe në pyjet shkurre. Kushtet ekologjike të territorit shqiptar garantojnë kërkesat e bimës për faktorët klimatik e tokësor të nevojshëm në kultivimin me sukses në rreth 70% të territorit.

Megjithatë, brenda këtij territori të gjerë, ka mjaft zona ku krijohen kushte specifike të kondicionuara nga elementë me ndikim të madh në disa nga treguesit e klimës. Afërsia me detin, zonaliteti vertikal, grykat e lumenjve etj., janë faktorët që më së shumti ndikojnë në regjimin e temperaturave dhe atë të reshjeve. Edhe pse, temperaturat minimale absolute dhe shuma e temperaturave efektive mbi 10°C janë brenda kufijve të lejueshëm të biologjisë së shegës, tendenca e ndryshimeve klimatike për ngjarje ekstreme më të shpeshta nxjerr në pah domosdoshmërinë e vlerësimit të kushteve të klimës në zona të catuara.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm është vlerësimi i regjimit të reshjeve i lidhur me mundësinë e ujitjes. Shpërndarja e reshjeve gjatë vitit në territorin e vendit tonë është tipike mesdhetare, me reshje të shumta gjatë gjysmës së ftohtë të vitit dhe reshje të pakta gjatë gjysmës së ngrohtë e me thatësi që mund të zgjatë edhe disa muaj.

Regjimi i ujit në shegishte është një nga faktorët që ndikon në shtimin e fenomenit të plasaritjes dhe çarjes së frutit. Ky është dhe një nga problemet që ndikon në tregtimin e prodhimit dhe si i tillë është edhe një nga treguesit që kemi vlerësuar në këtë studim.

Faktorët e tjerë si madhësia e fermës, marketingu etj , janë të lidhur ngushtë me drejtimin që jepet një aktiviteti të tillë dhe janë faktorët që zakonisht nuk janë vlerësuar. Eksperiencat e mjaft fermave në shqipëri kanë treguar se jo në pak raste investime të bëra në disa kultura, për shkak të sipërfaqeve të vogla në dispozicion, duke mos arritur të kthehen në burimin kryesor të të ardhurave të familjes, të lihen në aktivitete të dorës së dytë ose të abandonohen duke bërë që të mos japin efektivitetin e dëshiruar. Duke studiuar kërkesat e tregut, dinamikën e lëvizjes së çmimit, kultivarët që shkojnë më shumë ose thjesht njohja e varieteteve që kultivohen në fshatrat e zonës në të cilën banojmë, mund të jenë gjithashtu një ndihmë e konsiderueshme në zgjedhjen e kultivarit.

Shtimi i sipërfaqeve të reja nëpërmjet skemave të mbjelljes në nivel ferme të kësaj kulture kanë nxjerrë në pah, domosdoshmërinë e vlerësimit të kultivarëve më të përshtatshëm për të pasur efektivitetin e duhur në kultivimin e saj. Këtij qëllimi i kushtohet ky studim i cili ka filluar këtë

vit për të bërë vlerësimin e kultivarëve të rinj të shegës (që ndoshta kanë qenë prezent edhe më parë në vendin tonë) dhe po gjejnë përhapje në sipërfaqe të konsiderueshme në mbjelljet e reja.

2. Metodologjia e ndjekur

Për realizimin e këtij studimi është ndjekur metoda e evidentimit dhe më pas e vlerësimit të disa prej etapave më të rëndësishme të ngritjes dhe shfrytëzimit të një pemëtoreje.

Fillimisht është filluar puna me evidentimin e sipërfaqeve më të konsiderueshme të mbjella me shegë (kryesisht në zonën e Jugut të vendit)

Krahas saj, është marrë informacion për kultivarët që po shtohen. Pas kontaktit me pronarët e këtyre shegishteve është proceduar me informacione për ecurinë e zhvillimit të bimëve të reja dhe problematikat me të cilat këta fermerë janë përballur për kultivimin me sukses të kësaj kulture.

Të dhënat e marra janë krahasuar me tregues të zhvillimit dhe prodhimitarisë së shegëve që ndodhen të kultivuara në zonat e fshatrave ku janë këto shegishte.

Janë marrë të dhëna për këto tregues:

- Zhvillimin e përgjithshëm të bimëve të reja.
- Gjendjen e përgjithëshme të parcelave.
- Ecurinë e frutifikimit dhe të prodhimit (në rastet e shegëve që kanë hyrë në prodhim).
- Cilësinë e frutave (duke bërë dhe matjet e nevojshme laboratorike)
- Nivelin e tregut dhe interesin ekonomik të fermës.

Fermat që ne kemi identifikuar me sipërfaqe të konsiderueshme janë në Dukat-Vlorë, në Poro të Fierit, në Kolonjë-Lushnje dhe në sipërfaqe të reduktuara në Skrofotinë-Vlorë, ku janë disa nga kultivarët e huaj dhe të vendit me të cilët janë krahasuar treguesit e kultivarëve të kultivuar në parcelat e tjera.

3. Rezultate dhe diskutime

Fillimisht me pronarët e shegishteve janë marrë kontaktet dhe informacionet për madhësinë e fermës, kultivarët, kohën e mbjelljes etj.. Në fshatin Dukat, kemi kontaktuar me Z. Ariz Kapo (njëkohësisht dhe agronom), Z. Esat Kapo dhe Z. Bledar Ferruni, të tre të investuar dhe të apasionuar për kulturën e shegës. Të tre kanë tentuar mbjelljen e një kultivari të ri *Jolly Red*, importuar nga Italia me karakteristika të cilësuara nga importuesit si një kultivar me fara të reduktuara, i grupit të shegëve të ëmbla, i përshtatshëm për frut të freskët dhe përpunimi industrial. Bimët një sjellë në fillim të vitit 2016 janë mbjellë në tokë në fund të pranverës (afate disi të vonshme) dhe kanë zënie të dobët. Importuesi i saj është shprehur se difekti në zënie e fidanit kanë ardhur si pasojë e cilësive të fidanit dhe jo për cilësi të kultivarit. Sasia e pakët e bimëve që kanë zënë kanë pasur një zhvillim normal. Është ende herët për të bërë vlerësim për këtë kultivar dhe ky do të jetë objekt i studimit në vitet në vijim.

Dy sipërmarrësit e tjerë, Z. Esat Kapo dhe Z. Ariz Kapo, kanë mbjellë krahas *Jolly red* edhe kultivarin *Hicaznar*, shegë me origjinë Turke, me frut me shije të ëmbël në majoshe me fara të buta dhe me cipë me ngjyrë të errët në të kuqe.

Parcelat e mbjella me sipërfaqe 2 Ha dhe 0.6 Ha janë në vitin e dytë pas mbjelljes, kanë zhvillim të mirë dhe një pjesë e tyre ka filluar të prodhojë frutat e parë. Treguesit e frutave do t'i paraqesim më poshtë.

Ferma tjetër ka qenë ferma e Z. Kosta Bifsha, sipërmarrës i sukseshëm, ka investuar në një tokë 20 ha të marrë me qera në fshatin Poro-Fier, ku ka mbjellë kultivarin Wonderfull, dhe ka si destinacion të prodhimit krahas tregun e freskët edhe për industri. Është gjithashtu investitor në fabrikë për nxjerrjen e lëngut të shegës.

Shegët në këtë fermë janë në vitin e katërt, bimët janë me zhvillim normal dhe pjesa më e madhe kanë hyrë në prodhim. Sipas pronarit të saj, kjo është një sipërmarrje me interes dhe kultivari ka shkuar shumë mirë duke plotësuar pritshmëritë e tij dhe ka arritur të marrë 5-6 kg/për bimë gjatë këtij sezoni.

Ferma tjetër e marrë në studim e Z. Gëzim Gani në Kolonjë-Lushnje, është në moshë 6 vjeçare, e kultivartit *Hicaznar* dhe është shegishte e cila ka hyrë në prodhim. Nga të dhënat që morëm gjatë intervistës së tij kemi konstatuar se ky kultivar ka shkuar shumë mirë në këtë zonë duke dhënë edhe rendimente të kënaqshme dhe me leverdi ekonomike.

Në çdo parcelë janë marrë mostra të ftutave në kohën e vjeljes dhe është bërë analiza e treguesve biometrik e kimik në laborator.

Tabelë 1. Të dhënat e treguesve biometrik dhe kimik të kultivarëve të shegës të mbjella në katër ferma të ndryshme.

Kultivri	Diametri i frutit D/d	Pesha e frutit	%/ sheqerit	Aciditeti Total %	Raporti sheqer/aciditet
Hicaznar (Dukat)	109/118	631.5	17.8	1.72	10.34
Hicaznar Skrofotinë	132/140	711	18.5	1.58	11.7
Hicaznar Kolonjë	139/148	831.5	19.2	1.65	11.6
Wonderfull Poro	116/103	261	16.2	0.95	17.05
Wonderfull Skrofotinë	113/121	402	17	1.03	16.5

4. Konkluzione

Mbi bazën e rezultateve të krahasuara midis kultivarëve dhe për pozicione të ndryshme të të njëjtit kultivar të paraqitur në Tabelën Nr. 1, konstatohet se treguesit janë të ndryshëm. Megjithëse fermat ku kemi bërë studimin kanë investuar në teknologji, influenca ndaj tokës dhe klimës ka ndryshime kanë bërë që treguesit të kenë diferenca. Rezultatet e treguesit të raportit sheqer/aciditet tregojnë se dy kultivarët kanë shfaqur vetitë e tyre pavarësisht fermës ku janë kultivuar. Kultivari Wonderfull ka vlerat më të larta të këtij treguesi se kultivari Hicaznar, vlera që edhe sipas klasifikimit nga Evreinoff (1957), klasifikohet në vlerat e kultivarëve të ëmbël, ndërsa kultivari Hicaznar është kultivar i pozicionuar midis kultivarëve të ëmbël dhe atyre acid.

5. Mesazhe për fermerët

Shega është një nga drufrutoret me rëndësi e cila për shkak të karakteristikave dhe cilësive të saj, të kërkesave të tregut, i japin asaj përparësinë për një përhapje më të gjerë në vendin tonë. Shtimi i sipërfaqeve me shegë kërkon paraprakisht vlerësimin e kushteve klimatike e tokësore për të vlerësuar nëse jemi në një zonë që krijon kushte optimale, apo në një zonë ku mund të “rezikojmë” në rast se mbjellim këtë kulturë. Krahas saj edhe zgjedhja e kultivartit është një nga vendimet më të rëndësishme. Megjithëse në vendin tonë ka një larmi bimësh që zotërojnë cilësi

e shije të pranuar nga tregu për këtë frut, ato në treg gjenden përballë frutash të kultivarëve të konsoliduar që ekzistojnë në botë dhe që me cilësitë e tyre bëjnë diferencën ndaj kultivarëve vendas. Kjo ka bërë që investitorët e rinj të kërkojnë kultivarë që janë më konkurrues në treg. Nga ana tjetër investimi i bërë me kultivarë të panjohur apo me materjal bimor të pakontrolluar mund të ndikojë në konsum energjie e kohe të padëshirueshme.

Përveç kërkesave specifike të kultivarëve, veçorive të tokës dhe klimës së zonës duhet të vlerësohen disa faktorë që zënë një peshë të rëndësishme në efektivitetin e shëgishtes të tillë si, madhësia e tokës, faktorët që ndikojnë në marketingun e prodhimit dhe e fundit për nga rëndësia, kohën që nevojitet për mirëmbajtjen dhe shërbimet e duhura.

Dy kultivarët e shëgës, *Wonderfull* dhe *Hicaznar*, të cilët po gjejnë përhapje të madhe edhe në vendin tone, për vlerat e larta cilësore e tregtare, janë përshtatur mire, kanë shfaqur cilësitë e tyre në vendet ku janë mbjellë dhe përbëjnë kultivarë potencial për mbjelljet e reja.

Specialist:
Adhurim Lazaj